



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 131, datë 30.09.2025

**PËR
MIRATIMIN E SHOQËRISË “RSM ALBANIA” SH.P.K., SI SHOQËRI AUDITUESE
PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE
“ABI INVEST” SH.A., DHE FONDEVE TË INVESTIMIT NËN ADMINISTRIM, PËR
VITIN FINANCIAR QË MBYLLET NË DATË 31.12.2025**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 35, të Ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, si dhe të Rregullores nr. 89, datë 27.06.2016 “Për kriteret dhe kërkesat për miratimin e shoqërisë audituese të SHAFP dhe SIK”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e shoqërisë “RSM Albania” sh.p.k., si shoqëri audituese për auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë administruese “ABI Invest” sh.a., dhe fondeve të investimit “ABI EIA”, “ABI Flex Euro” dhe “ABI Flex USD”, për vitin financiar që mbyllet më 31.12.2025.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Fondeve, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Saimir TOLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Mimoza KAÇI**